



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 402/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Aleanca Kosova e Re (AKR), në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**Konstatohet e tërhequr ankesa** me numër: Anr.365/2013, të datës 29.10.2013, të parashtruara në PZAP nga Aleanca Kosova e Re (AKR).

### Arsyetim

PZAP, me datë 31.10.2013, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr.365/2013, të datës 29.10.2013, të parashtruara në PZAP, kundër subjekteve politike Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në të cilën kërkohet që të tërhiqen ankesa e lartpërmendura nga shqyrtimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të sipërsënuara, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohen ankesën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 402/2013 më datën 31.10.2013

Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi

